

PERGJEGJËSIA LIGJORE PËR PALËT E TRETA (PËRVEÇ PASAGJERËVE)

MBROJTJE DHE DËMSPËRBLIM

1.1 Siguruesi bie dakord të dëmshpërblejë të siguruanin për çdo shumë të paguar nga i siguruari ndaj një personi tjetër (palë e tretë), për shkak se është ligjërisht përgjegjës, si pronar i anijes, për çdo aksident të ndodhur gjatë periudhës së mbulimit me sigurim, për çdo dëm apo humbje që rrjedh si pasojë e ngjarjeve që vijnë:

- 1.1.1 humbje apo dëmtim i një prone të lëvizshme ose të palëvizshme, ose çdo gjëje tjetër, përveç anijes së siguar, me kusht që kjo humbje apo ky dëm të mos mbulohet nga sigurimi H&M.
- 1.1.2 çdo përpjekje për/apo realizim të nxjerrjes nga cekina, zhvendosjes apo shkatërrimit të çdo prone të lëvizshme ose të palëvizshme, përfshirë edhe mbetjet e anijes së siguar.
- 1.1.3 përgjegjësi e të siguarit që lind nga një kontratë për rimorkim të zakonshëm gjatë manovrave për të hyrë apo dalë nga porti.
- 1.1.4 humbje jete, lëndime, sëmundje ose shpenzime të kryera për shpëtimin e jetës së palëve të treta

1.2 Siguruesi bie dakord të dëmshpërblejë të siguruanin për çdo ngjarje që vijon, kur ka ndodhur brenda periudhës së mbulimit, si:

- 1.2.1 kosto shtesë për karburant, siguracion, paga, furnizime me ushqime dhe materiale dhe taksa portuale, kur këto shpenzime janë të arsyeshme dhe janë kryer me qëllimin e vetëm që të zbarkojnë nga anija personat e sëmurë ose të plagosur, klandestinët apo personat e shpëtuar në det.
- 1.2.2 shpenzime shtesë nga shpërthimi i epidemive në bordin e anijes ose në breg
- 1.2.3 shpenzimet për heqjen e mbetjeve të anijes së siguar nga çdo vend që është në pronësi, është marrë me qera apo zënë nga i siguruari.
- 1.2.4 kostot legale të kryera nga i siguruari, ose të cilat i siguruari është i detyruar ti kryejë, për të shmangur, minimizuar ose kundërshtuar përgjegjësinë, vetëm pasi ka marrë miratimin me shkrim nga Siguruesi.

PËRJASHTIME

1.3 Pavarësisht nga klauzolat 1.1 dhe 1.2, Klauzola 1 nuk mbulon ndonjë përgjegjësi që lind prej si vijon:

- 1.3.1 çdo pagesë direkte ose indirekte e të siguarit që rrjedh nga përgjegjësitë ligjore të të siguarit, ose çfarëdo përgjegjësi tjetër në lidhje me aksidentet ose sëmundjet e një anëtari të ekuipazhit apo punonjësi tjetër që ka lidhje me anijen e siguar, ngarkesën apo riparimin e sajë.
- 1.3.2 përgjegjësitë e të siguarit që lindin nga një marrëveshje e shprehur apo e nënkuptuar

në lidhje me vdekjen, plagosjen apo sëmundjen e një personi të punësuar me kontratë

- 1.3.3 ngarkesa apo ndonjë pronë tjetër që është ngarkuar ose do të ngarkohet në anije por kjo klauzolë 1.3.3 nuk përjashton humbjet ose dëmtimet që rrjedhin nga shpenzimet shtesë për zhvendosjen e ngarkesës nga mbetjet e anijes së rënë në cekinë.
- 1.3.4 sende në pronësi të ndërtuesit apo riparuesve të anijes të cilat ndodhen në bordin e anijes së siguruar.
- 1.3.5 përgjegjësi që lind nga një kontratë ose dëmshpërblim në lidhje me kontejnerët, pajisjet, karburantet ose pasuri tjetër në anije e cila është në pronësi ose me qera nga i siguruari
- 1.3.6 para kesh, letra me vlerë, gurë dhe metale të çmuar, objekte të rrallë dhe me vlerë, sendet personale të ekuipazhit.
- 1.3.7 shpenzime për karburant, siguracion, paga, materiale, ushqime dhe taksa portuale që rrjedhin nga vonesat e anijes për ndërrimin e ekuipazhit
- 1.3.8 gjoba ose penaltete që rrjedhin nga ngarkimi i anijes mbi kapacitetet ose peshkimi i paligjshëm
- 1.3.9 ndotja ose dëmtimi i çdo pasurie personale.
- 1.3.10 avaria e përgjithshme, operacioni i shpëtimit dhe përpjekjet e kapitenit për shmangien ose minimizimin e demit, shpenzimet e shpëtimit dhe përgjegjësia që lind nga përplasja, kur janë mbi shumën e siguruar.
- 1.3.11 tërmetet dhe shpërthimet vullkanike.

1.4 GJITHMONË ME KUSHT QË:

- 1.4.1 Siguruesi duhet njoftuar brenda 24 orëve për çdo ngjarje që mund të rezultojë me kërkesë për dëmshpërblim ose që mund ta bëjnë të siguarin përgjegjës për shpenzime dhe kosto që mbulohen nga ky sigurim.
- 1.4.2 I siguruari nuk duhet të pranojë përgjegjësinë për ndonjë ngjarje të siguruar pa marrë miratim me shkrim nga Siguruesi.

2 KUFIRI I PËRGJEGJËSISË

- 2.1 në asnjë rast përgjegjësia e siguruesit sipas këtij sigurimi nuk mund jetë më e madhe se pjesa përpjestimore e shumës së siguruar në lidhje me çdo aksident apo seri aksidentesh që rrjedhin nga e njëjta ngjarje.

3 PJESA E ZBRITSHME

- 3.1 pavarësisht parashikimeve të klauzolës 1, asnjë kërkesë për humbje apo dëm nuk do të paguhet nga ky sigurim nëse kjo humbje apo ky dëm, ose agregati i tyre, nuk e kalojnë vlerën e pjesës së zbritshme.

4 LUNDRIMI

Anija mund të akostohet ose ç'aksotohet, të hyjë në dok, të lundrojë me ose pa pilot, të bëjë

lundrime prove, të ndihmojë ose të rimorkiojë anije të tjera në rrezik; por nuk mund të rimorkiohet, me përjashtim kur kërkohet nga rregullat portuale ose kur ka nevojë për ndihmë. Gjithashtu nuk mund të kryejë operacione shpëtimi ose rimorkimi sipas një kontrate të mëparshme, nëse nuk merr miratimin me shkrim të siguruesit. Kjo klauzolë nuk përjashton rimorkimin që ka lidhje me operacionet e ngarkim/shkarkimit..

5 PËRFUNDIMI

Kjo klauzolë 5 ka përparësi mbi çdo parashikim tjetër të këtij sigurimi që nuk është në përputhje me të.

Me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord nga siguruesi, ky mbulim me sigurim përfundon automatikisht kur:

5.1 ndryshon shoqëria klasifikuese e anijes ose kur pezullohet, ndërpritet, anulohet ose përfundon certifikata e klasit.

5.2 ndryshon pronësia ose flamuri, transferohet tek një menaxher i ri, çarterohet ose jepet titull për përdorimin e anijes. Kur titulli për përdorim jepet pa miratimin me shkrim të siguruesit, ky sigurim përfundon 15 ditë pasi jepet ky titull, pavarësisht nëse anija është në port apo në lundrim.

6 THYERJA E KUSHTEVE TË MBULIMIT

Sigurimi vazhdon edhe në rastet e thyerjes së kushteve të mbulimit në lidhje me ngarkesën, lundrimin, vendndodhjen, rimorkimin, operacionet e shpëtimit apo datës së lundrimit, por me kusht që të jetë njoftuar Siguruesi dhe pasi Siguruesi ka miratuar me shkrim amendimet në kushtet e mbulimit dhe të jetë paguar çdo shtesë primi të mundshme.

7 KUSHTI PËR DETYRIMET E TË SIGURUARIT

Asnjë detyrim ose interes sipas këtij sigurimi nuk do të jetë i pagueshëm apo i detyrueshëm për Siguruesin dhe nuk do të njihet nëse njoftimi i këtij detyrimi apo interesi të nënshkruar nga i Siguruari nuk është shtuar në këtë Policë dhe Polica me këtë shtojcë është lëshuar përpara pagesës së çdo dëmi apo kthimi primi.

8 MASAT E ARSYESHME

Është kusht i kësaj marrëveshjeje që i Siguruari dhe operatorët apo agjentët që i shërbejnë të marrin masa të arsyeshme për ndalimin apo minimizimin e një humbjeje e cila mund të jetë e mbuluar nën këtë sigurim

9 KTHIMET PËR ANULLIMET

Nëse ky sigurim anulohet, me marrëveshje apo sipas klauzolës 5, bëhet kthimi i primit në përpjestim për çdo muaj të pafilluar, me kusht që të mos kenë ndodhur dëme në anijen e siguaruar gjatë periudhës së mbulimit me sigurim.

10 PËRJASHTIME NGA LUFTA, GREVAT, VEPRIMET KEQDASHËSE DHE RREZIQET BËRTHAMORE

Në asnjë rast ky sigurim nuk mbulon përgjegjësitë, kostot apo shpenzimet që rrjedhin nga rreziqet që vijnë:

- 10.1 lufta, lufta civile, revolucionet, rebelimet, etj. ose çdo veprim armiqësor nga lufta me një vend tjetër.
- 10.2 ndalimi i anijes, arresti, rrëmbimi nga piratët dhe pasojat nga këto veprime.
- 10.3 minat lundruese, silurët, bombat ose armë të tjera lufte.
- 10.4 grevat, ndërprerja e punës nga punëdhënësit, kryengritjet, trazirat civile
- 10.5 aktet terroriste ose veprimet e motivuara politikisht.
- 10.6 përdorimi i armëve të luftës ose shpërthimet e eksplozivit nga një person i motivuar politikisht.
- 10.7 armët atomike ose bërthamore

Ky sigurim është subjekt i ligjit dhe praktikave të Republikës së Shqipërisë.